



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.04.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i aktit normativ nr. 1, datë 20. 03. 2019 “Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS)”.
2. Vazhdim i shqyrtimit nen për nen të projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Elena Xhina, Sadi Vorpsi, Luan Duzha, Pjerin Ndreu, Elona Hoxha, Antoneta Dhima, Xhemal Qefalia, Paulin Sterkaj, Spartak Braho.

Mungojnë:

Myslym Murrizi, Luan Harusha, Edmond Rrushi, Anduel Xhindi, Ylli Shehu.

Të ftuar:

Petro Koçi – Zëvendësministër i Mbrojtjes

Adi Ndoni - Drejtor i Monitorimit dhe Jetësimit të Prioriteteve në Ministrinë e Mbrojtjes

Alfred Progonati – Prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme

Kujtim Luli - Prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita, kolegë!

Para se të lexoj rendin e ditës, me të cilin kolegët janë njohur paraprakisht, dua t’i uroj mirëseardhjen kolegut më të ri të Komisionit të Sigurisë Kombëtare, zotit Lefter Maliqi. Zoti Maliqi, mirë se erdhët në Komisionin për Sigurinë Kombëtare!

Në rendin e ditës së mbledhjes së komisionit kemi planifikuar dy çështje:

1. Miratimin e aktit normativ nr. 1, datë 20. 03. 2019 “Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut”. Të ftuar nga Ministria e Mbrojtjes për këtë çështje kemi zotin Petro Koçi, zëvendësministër i Mbrojtjes dhe kolonel Adi Ndoni, drejtor i Monitorimit dhe Jetësimit të Prioriteteve në Ministrinë e Mbrojtjes. Faleminderit zotërinj për prezencën në komision! Relator i komisionit për përmbajtjen e këtij akti normativ do të jetë kolegu Xhemal Qefalia.

2. Vazhdim i shqyrtimit nen për nen të projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Fjalën e ka zoti Koçi për të prezantuar aktin normativ të sjellë nga Ministria e Mbrojtjes.

Ju lutem, zoti Koçi, përqendrohuni në arsyet e urgjencës që justifikojnë nxjerrjen e këtij akti normativ. Më pas fjalën e ka zoti Qefalia.

Faleminderit!

Petro Koçi – Faleminderit, zonja kryetare e komisionit!

Përshëndetje të nderuar anëtarë dhe anëtare të Komisionit për Sigurinë Kombëtare.

Siç është paraqitur, në datën 20. 03. 2019 Këshilli i Ministrave ka miratuar me një akt normativ pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut.

Siç dihet, Shqipëria ka pothuajse 10 vjet që nuk ka qenë pjesë e misioneve të Kombeve të Bashkuara. Në përputhje me objektivat e qeverisë për ta rritur protagonizmin e Shqipërisë në këtë kuadër, për t’i shërbyer objektivit që ne kemi për t’u bërë pjesë e Këshillit të Sigurimit si një anëtar i përkohshëm, por duke e parë edhe në kuadrin e probleme rajonale ku Kombet e Bashkuara kanë një funksion të rëndësishëm (objektivat e Kosovës për t’u bërë pjesë e Kombeve të Bashkuara me anëtarësi të plotë dihen), ne e kemi pasur qëllim të bëhemi pjesë e misioneve të OKB-së.

Para disa kohësh është zhvilluar një takim midis shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave tona të Armatosura dhe drejtorit të Departamentit të Operacioneve Paqeruajtëse në

OKB për mundësinë e pjesëmarrjes së Forcave tona të Armatosura në një nga këto misione. Më në fund është arritur marrëveshja që ne të jemi pjesë e misionit të OKB-së në Sudanin e Jugut.

Në fakt, ishte parashikuar që ky mision të fillonte në qershor të këtij viti, por planet janë përshpejtuar dhe u desh që të kalohej me akt normativ në mars, sepse misioni fillon në muajin prill.

Meqenëse akti normativ ka fuqinë e ligjit, dy pjesëmarrëset oficere në këtë mision kanë shkuar atje në një përgatitje paradisllokimi dhe së shpejti fillon pjesëmarrja në mision.

Kjo pjesëmarrje është në përputhje me Kushtetutën, ligjin “Për Forcat e Armatosura”, misionin e Forcave të Armatosura dhe nuk ka asnjë pengesë në këtë rrafsh.

Siç thuhet edhe në relacion, oficeret tona nuk do të jenë pjesëmarrës në operacionet e terrenit, por do të jenë me detyra shtabi ose zbulimi. Në relacion ka një sërë shpjegimesh për këto detyra. Te pika e dytë, detyrat, akronimi FRR duhet të jetë RPF, sepse është bërë gabim në shkrim.

Besoj se jemi në kohën e duhur që projektligji të kalojë në seancë ditën e enjte.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Koçi!

Komisioni i Sigurisë është komisioni përgjegjës dhe i vetmi që do ta shqyrtojë këtë projekt. Fakti që ne e nisëm sot na jep mundësinë ta miratojmë ditën e enjte në seancë plenare.

Fjalën e ka zoti Qefalia,

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zonja kryetare!

Edhe unë i bashkohem mendimit të zëvendësministrit për mundësinë për të miratuar aktin normativ “Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut”.

Të nderuar kolegë,

Nëse i referohemi nenit 101 të Kushtetutës, aty parashikohet që Këshilli i Ministrave, në rast nevojë dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit për marrjen e masave të përkohshme. Gjithashtu, përcaktohet një afat prej 45 ditësh. Pra, akti normativ është nënshkruar në datën 20 mars, kështu që, brenda 45 ditëve Kuvendi i Shqipërisë duhet të vendos me ligj për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionet e përcaktuara në nenin respektiv.

Në këtë kuadër, Ministria e Mbrojtjes ka paraqitur aktin normativ pranë Këshillit të Ministrave brenda afatit kohor të kërkuar, në mënyrë që për herë të parë Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë të marrin pjesë në një mision kaq të rëndësishëm të Kombeve të

Bashkuara. E rëndësishme është që pjesa më e madhe e vendeve pjesëmarrësve janë pjesë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Trajtimi i ushtarakëve do të bëhet nga Kombet e Bashkuara, kurse për dietat dhe mënyrat e tjera të trajtimit financiar do të jetë përgjegjëse Ministria e Mbrojtjes.

Nga informacionet dhe kontaktet që kam pasur me zëvendësministrin dhe përfaqësuesin tjetër ushtarak, i cili është në panel, bëhet fjalë për ushtarakë të gradës së mesme, nga kapiten deri në major.

Në këtë kuadër, të nderuar kolegë, ju ftoj ta miratojmë këtë akt pasi jemi konform ligjit dhe Kushtetutës që Kuvendi të japë dakordësinë përfundimtare që këta të ushtrojnë aktivitetin dhe veprimtarinë tyre pranë këtij misioni.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Qefalia!

Është e qartë që për këtë rast duhet të vendosë Kuvendi i Shqipërisë. Për çdo pjesëmarrje të Forcave të Armatosura në misionet që zhvillohen jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë përgjegjësinë e vendimmarrjes e ka Kuvendi.

Fjalën e ka zoti Maliqi.

Lefter Maliqi – Faleminderit, zonja kryetare!

Nuk e di si ka qenë procedura e mëparshme, por, duke qenë se është bërë fakt i kryer dhe forcat janë dislokuar për një trajnim paraprak, a duhet të shkonin para miratimit të aktit normativ nga parlamenti? Së dyti, mbi bazën e cilave kritere apo gradave është bërë përzgjedhja e këtyre dy oficerëve dhe sa kandidatë kanë qenë?

Ermonela Felaj – Kush do të përgjigjet, zoti Koçi apo zoti Ndoni?

Petro Koçi - Paraprakisht duhet thënë që akti normativ ka fuqinë e ligjit deri sa parlamenti të shprehet.

Së dyti, shkuarja në një mision paradislokimi dhe trajnimi është kompetencë e ministrit të Mbrojtjes. Pra, mund të dërgohen ushtarakë jashtë vendit me detyra të kufizuara pa qenë pjesëmarrës në mision. Pjesëmarrja në mision kërkon miratimin e Këshillit të Ministrave dhe pastaj të Kuvendit. Kështu që, nuk kemi asnjë problem për procedurën e deritanishme. Janë përzgjedhur dy ushtarake femra edhe për faktin për të plotësuar një rezolutë tjetër të Kombeve të Bashkuara për barazinë gjinore. Në këtë drejtim, besoj se kjo shpreh dinjitetin e Shqipërisë në këtë rol në një mision ndërkombëtar ushtarak në emër të Kombeve të Bashkuara.

Përzgjedhja e ushtarakëve bëhet gjithmonë në përputhje me kriteret e përcaktuara dhe me nevojat e gradës, sipas natyrës së misionit. Kjo natyrë misioni kërkonte këtë lloj grade. Përgjithësisht, ne po tentojmë që në këto misione ndërkombëtare të shkojnë ushtarakë, të cilët

nuk kanë qenë pjesë e këtyre misionëve në të kaluarën. Është një nga kriteret që ne e ndjekim në vijimësi, kuptohet pa cenuar cilësinë dhe plotësimin e detyrave në mision sipas nevojës që lidhet me gradën dhe natyrën e vështirësisë së detyrës. Kjo është një detyrë me natyrë zbulimi. Po të lexosh relacionin, të gjitha detyrat janë me natyrë informative dhe zbulimi.

Kështu që, besojmë se të dyja ushtarakët tona do ta plotësojnë më së miri dhe në nivelin e kërkuar detyrën që duhet të kryejnë si pjesëmarrës në një mision ndërkombëtar ushtarak në kuadrin e Kombeve të Bashkuara.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Koçi!

Besoj se është një rast i mirë që ju e keni vlerësuar çështjen e barazisë gjinore, sepse, shpeshherë, në diskutime që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e vajzave dhe grave në Forcat e Armatosura dhe Policinë e Shtetit, ngrihet diskutimi se sa i angazhojmë gratë dhe vajzat në detyra ose misione të rëndësishme.

Fjalën e ka zonja Dhima për pyetje dhe pastaj zonja Gjebrea.

Xhemal Qefalia – Nuk është barazi gjinore, sepse janë dy femra. Barazi do të ishte 1 me 1.

Ermonela Felaj – Nuk e dimë se si e kanë zbatuar në total.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti zëvendësministër i Mbrojtjes për prezantimin e këtij akti normativ!

Në relacionin që ju keni paraqitur, por edhe nga relatori u tha që ushtarakët që do të marrin pjesë në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut, do të marrin për ditët e qëndrimit në këtë mision, përveç pagës mujore, dieta ditore dhe vështirësi shërbimi në masën që do të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, u tha që të gjitha shpenzimet për mbarëvajtjen e misionit do të përballohen nga OKB-ja. A janë parashikuar këto shpenzime në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes apo do të kërkonin ndryshime në buxhetin e vitit 2019?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, zoti Koçi.

Petro Koçi – Siç e thatë edhe ju, nga pikëpamja financiare misioni është krejtësisht i përballueshëm, sepse ai financohet nga vetë OKB-ja. Për sa i përket dietave dhe sigurimit të jetës së ushtarakëve, këto janë parashikuar brenda fuqisë buxhetore të Ministrisë së Mbrojtjes dhe nuk ka nevojë për ndonjë shtesë nga vendimi i Këshillit të Ministrave, i cili është i domosdoshëm për të zbatuar këtë projektligj sapo të kalojë ditën e enjte në parlament.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Po, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti zëvendësministër për sqarimin për këtë mision të rëndësishëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë! Sa është numri total i Forcave të Armatosura në misione të tjera të Kombeve të Bashkuara? Ju komplimentoj për miratimin e rezolutës së fundit për paqen dhe sigurinë nga Ministria e Mbrojtjes! Keni një reagim të shpejtë për sa i përket mbështetjes së grave dhe vajzave që kontribuojnë në Forcat e Armatosura dhe konkretisht në këtë mision kaq të rëndësishëm.

Ju uroj suksese!

Faleminderit!

Petro Koçi – Në misionet jashtë vendit kemi rreth 230 ushtarakë. 120 ushtarakë janë vetëm në Afganistan. Gjithashtu, kemi ushtarakë në misionet në Letoni, në KFOR, në misionin *Sea Guardian* në detin Egje, por dhe në misione me natyrë më të vogël në numër, siç janë ato të BE-së në Mali dhe Bosnjë-Hercegovinë.

Në gjeografinë e pjesëmarrjes në misione ndërkombëtare kemi këtë investim të ri të Republikës së Shqipërisë për paqen dhe stabilitetin në botë, siç është pjesëmarrja në misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut.

Sigurisht, ne jemi përpjekur gjithmonë që të rriten numri i grave dhe vajzave në misionet ndërkombëtare. Në përgjithësi, në këtë politikë ne kemi ecur me hapa të shpejtë. Vitet e fundit është rritur numri i përgjithshëm i grave dhe vajzave në Forcat e Armatosura, por edhe pjesëmarrëse në misionet ndërkombëtare.

Natyrisht, gjithçka llogaritet me vështirësitë e misioneve, por edhe në Afganistan dhe në Detin Egje, ku natyra e misionit është më delikate, ka pasur femra pjesëmarrëse. Pjesëmarrja në misionin në Sudanin e Jugut është e vështirë jo për nga natyra e mirëfilltë e vendndodhjes së ushtarakeve, por si pasojë e gjendjes në atë vend. Është një gjendje shumë kaotike, sepse ka probleme politike dhe social-ekonomike. Duhet përshëndetur të dyja ushtaraket, si kapitenia dhe edhe majoria, për kurajën dhe gatishmërinë për të marrë pjesë në këtë mision.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Koçi!

Po, zoti Sterkaj.

Paulin Sterkaj – Si të gjithë kolegët edhe unë jam dakord. Sa është kohëzgjatja e misionit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është në relacion.

Petro Koçi – Është 1 vit, por ka edhe mundësinë për t'u zgjatur.

Paulin Sterkaj – 1 vit do të zgjasë misioni i ushtarëve tanë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Besoj se akti është i qartë. Siç e shpjegoi edhe zoti Koçi, misioni ka filluar më parë nga sa parashikohej. Për këtë arsye Ministria e Mbrojtjes dhe Këshilli i Ministrave janë të detyruar të operojnë me akt normativ. Akti normativ e sjell në fuqi që nga momenti i miratimit të tij në Këshillin e Ministrave, por kjo vlen vetëm për 45 ditë. Nëse brenda 45 ditëve nuk miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë, akti normativ e humbet fuqinë e tij. Ky është kushti që ka akti normativ në vetvete, që është i shprehur edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kalojmë në miratimin e aktit në fjalë. Kush është dakord në parim me aktin normativ nr. 1, datë 20. 03. 2019? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në miratimin nen për nen.

Nenin 1.

Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3, që ka të bëjë me të drejtat që do të kenë ushtarakët që do të jenë të përfshirë në këtë mision për sa i takon pagës mujore dhe përfitimeve të tjera financiare.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4 ka të bëjë me hyrjen në fuqi menjëherë të aktit normativ dhe botimin e tij në Fletoren Zyrtare.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me Aktin Normativ “Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit zoti Koçi dhe zoti Ndoni për prezencën tuaj në komision!

Petro Koçi – Faleminderit komisionit!

MBYLLET MBLEDHJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.04.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Vazhdimi i shqyrtimit nen për nen të projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Marrin pjesë :

Ermonela Felaj, Elena Xhina, Sadi Vorpsi, Luan Duzha, Pjerin Ndreu, Elona Hoxha, Antoneta Dhima, Xhemal Qefalia, Paulin Sterkaj dhe Spartak Braho.

Mungojnë:

Myslim Murrizi, Luan Harusha, Edmond Rushi, Anduel Xhindi dhe Ylli Shehu.

Të ftuar:

Alfred Progonati - Prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme

Kujtim Luli - Prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Vazhdojmë mbledhjen për diskutimin e ligjit për Policinë Gjyqësore.

Herën e fundit diskutimin e kemi lënë te neni 22 i projektligjit, i cili bën fjalë për transferimin e oficerëve të Policisë Gjyqësore.

Kishte një sugjerim nga zoti Sterkaj, që të refleктоhej më mirë rasti kur transferimi i oficerit të Policisë Gjyqësore bëhet për shkak se ekziston një situatë reale rreziku për jetën dhe shëndetin e këtij punonjësi ose të familjarëve të tij. Me të drejtë, zoti Sterkaj propozoi të mos ndiqej afati i përgjithshëm. Pra, projekti parashikon që, mbasi bëhet kërkesa nga personi që ndodhet në situatën e përshkruar pak më lart, Komisioni i Policisë Gjyqësore, jo më vonë se 10 ditë, vendos për transferimin ose jo të punonjësit të Policisë Gjyqësore. Me të drejtë, zoti Sterkaj parashitroi kërkesën që të bënim një diferencë, që në këtë rast vendimmarrja të ndodhte në një kohë të ndryshme nga ajo e rasteve të tjera të transferimit.

Doja të merrja edhe opinionin e dy kolegëve të prokurorisë, të zotit Luli dhe zoti Progonati, nëse mundet që në pikën 4 të nenit 22 të fusim një fjali, që në rastet kur ekziston një situatë reale rreziku ndaj jetës dhe shëndetit të punonjësit të Policisë Gjyqësore ose të familjes së tij, Komisioni i Policisë Gjyqësore të vendosë për transferimin brenda 48 orëve nga kërkesa e këtij punonjësi.

U munduam të bëjmë një situatë paralele me vendimmarrjet që bëjmë në rastet kur personit kërkohet t'i hiqet liria dhe brenda 48 orëve ai duhet të paraqitet para gjykatës dhe kjo e fundit duhet të vendosë për heqjen ose jo të lirisë së personit. Edhe në këtë rast supozuam se 48 orë është kohë e mjaftueshme që komisioni të mblidhet dhe të vendosë nëse një punonjësi të Policisë Gjyqësore apo familjarëve të tij i rrezikohet jeta dhe shëndeti dhe se për këtë arsye duhet të merren masa që ai të transferohet nga vendi i punës.

Besoj se e kemi edhe mirëkuptimin e kolegëve, sepse kjo është koha më e shpejtë e mundshme e veprimt.

Po, zoti Luli.

Kujtim Luli – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë, mendoj që është një zgjidhje e drejtë. Madje, mund të vendoset fjala “menjëherë”. Ky është një term më i shpejtë. Terminologjia është “menjëherë” ose “brenda një afati të arsyeshëm”. “Brenda një afati të arsyeshëm” është shumë e gjatë koha, kurse “menjëherë” e përfshin 24-orëshin.

Ermonela Felaj – Në fakt, ne ishim në diskutimin midis përdorimit të termit “menjëherë” dhe “48 orë”, por menduam se Komisioni i Policisë Gjyqësore duhet të arsyetojë që ka një situatë reale të rrezikimit të jetës dhe shëndetit të punonjësit apo të familjarëve të tij. Për këtë arsye vendosëm për afatin 48 orë.

Kujtim Luli - Dakord jemi. Është e njëjta logjikë.

Ermonela Felaj – Komisioni i Ligjeve do ta vendosë përfundimisht këtë propozim, por unë them se ky i përfaron shqetësimet që patëm gjatë diskutimit të nenit.

Kolegë, a jeni dakord që nenin 22 ta votojmë, duke reflektuar në pikën 4 të tij fjalinë, që e detyron Komisionin e Policisë Gjyqësore, që, për rastin e parashikuar nga germa “c” e pikës 1, të veprojë brenda 48 orëve?

Faleminderit!

Miratohet neni 22.

Kalojmë te neni 23, i cili bën fjalë për shkarkimin dhe lirimin nga detyra.

A ka vërejtje për këtë nen?

Janë rastet e lirimit nga detyra, të dhënies së dorëheqjes, mosha e pensionit...

Nuk ka vërejtje.

Kush është dakord me nenin 23?

Faleminderit!

Miratohet neni 23.

Kalojmë te kreu V i projektit, i cili bën fjalë për veprimtarinë hetimore të Policisë Gjyqësore, konkretisht, neni 24.

Ftoj kolegët që për lehtësi pune të punojmë me tabelën.

Keni disa letra përpara. Ndoshta për momentin është pak e vështirë, por do të ecim më thjeshtë në atë mënyrë, se do të punojmë të gjithë me të njëjtin dokument.

Ky është një nen i përgjithshëm, ku prokurori urdhëron kryerjen e veprimeve hetimore gjatë hetimit të një çështjeje të caktuar. Besoj se është thjeshtë dhe vetëm përkthim fjalë për fjalë i asaj që thotë Kodi Procedurës Penale për veprimtarinë hetimore.

A ka ndonjë gjë për të shtuar nga kolegët për këtë nen?

Po, zoti Progonati.

Alfred Progonati – Në qoftë se do ta shikoni të arsyeshme, mund të bëjmë një plotësim këtu, gjithmonë, në frymën e ligjit që po miratoni. Ne synojmë që nëpërmjet ligjit të krijohet një strukturë e posaçme hetimore, që do të merret vetëm me hetimin. Do të ishte mirë që pas fjalës “urdhëron” të thuhet: “...strukturën hetimore të shërbimeve gjyqësore”.

Po, zonja Arbi.

Mimoza Arbi – Grupi i punës ka mbajtur këtë formulim për faktin se prokurori i urdhëron të gjitha shërbimet. Pra, këtu nuk kemi të bëjmë vetëm me Policinë Gjyqësore në Policinë e Shtetit, por me të gjitha shërbimet. Prandaj është lënë formulimi i përgjithshëm. Prokurori urdhëron hetimet për të gjitha shërbimet, qoftë në tatime, qoftë në dogana, qoftë në Policinë Ushtarake. Pra, është prokurori ai që e nxjerr urdhrin. Prandaj është lënë e përgjithshme.

Ermonela Felaj – Dakord.

Besoj se nuk ka nevojë për ndonjë koment tjetër. Është e qartë.

Kush është dakord me nenin 24?

Faleminderit!

Miratohet neni 24.

Kalojmë te nenin 25, kryerja e verimeve hetimore nga seksionet e Policisë Gjyqësore.

Është rasti që diskutuam kur morëm kohë për të vendosur për miratimin ose jo në parim të projektligjit. Ligji, me të drejtë, bën një ndarje të qartë se cilat janë seksionet dhe cilat janë shërbimet e Policisë Gjyqësore, se çfarë bën njëra dhe tjetra. Është e nevojshme, edhe për të mos lejuar të ketë kaos në veprimtarinë e Policisë Gjyqësore, të jetë e qartë se çfarë bëjnë oficerët e Policisë Gjyqësore të Policisë së Shtetit dhe se çfarë bëjnë ata, që janë vendosur në secilën nga prokuroritë, në Shkallën e Parë, në Apel dhe në Prokurorinë e Përgjithshme.

Ka ndonjë ndërhyrje nga kolegët? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 25?

Faleminderit!

Miratohet neni 25.

Kalojmë te neni 26, kryerja e verimeve hetimore nga seksionet dhe shërbimet e Policisë Gjyqësore.

Kolegë, a ka ndonjë ndërhyrje për këtë nen? Është nen deklarativ. Kështu që...

Kush është dakord me nenin 26?

Faleminderit!

Miratohet neni 26.

Kalojmë te neni 27, i cili bën fjalë për trajnimin fillestar për pranimin në Policinë Gjyqësore.

Paraprakisht, duke marrë shkas nga fakti që zoti Ndreu në pjesën e parë të diskutimeve që bëmë për këtë projektligj ka shtruar nevojën e domosdoshme të trajnimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore, jo thjesht nga Akademia e Sigurisë, por nga vetë institucioni i prokurorisë, i cili do të ushtrojë dhe drejtojë gjithë veprimtarinë hetimore, kam një propozim nga dy

përfaqësuesit e Prokurorisë së Përgjithshme, që tek institucionet, që do të bëjnë trajnimin fillestar dhe trajnimin, të shtohet: “Do të bëjnë trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm të oficerëve të Policisë Gjyqësore”. Pra, trajnimi të jetë në vijimësi.

Zoti Luli, a keni diçka për të shtuar për propozimin?

Kujtim Luli – Po.

Faleminderit!

Te neni 27, propozoj që krahas Akademisë të shtohet edhe Shkolla e Magjistraturës, sepse Policia Gjyqësore është një subjekt shumë i rëndësishëm i procedimit penal, sikurse edhe prokurori dhe gjykatat, që janë subjekte të këtij kodi. Trajnimi fillestar, para se ky të kalojë në strukturat hetimore ose në seksionin e Policisë Gjyqësore, të kryhet në bashkërendim midis Akademisë së Sigurisë dhe Shkollës së Magjistraturës, si udhëzimet e përbashkëta, si dhe me Prokurorin e Përgjithshëm të përfshirë, si institucion, sepse togfjalëshi “institucionet arsimore publike” është shumë i përgjithshëm. Kështu ka qenë edhe te ligji ekzistues, por nuk ka funksionuar siç duhet në trajnimin e Policisë Gjyqësore.

Ermonela Felaj – Atëherë, ju po thoni se duhet të themi: “Shkolla e Magjistraturës dhe Akademia e Sigurisë sigurojnë trajnimin fillestar dhe vazhdues të oficerëve të policisë Gjyqësore...?”

Po, në bashkëpunim me Komisionin e Policisë Gjyqësore dhe Prokurorin e Përgjithshëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, mundeni.

Pjerrin Ndreu – Këtu flitet për një trajnim, por se çfarë lloji trajnimi është ky, se sa kohë zgjat dhe se kush duhet t’i nënshtrohet, nuk ka asnjë të dhënë.

Ermonela Felaj – Mund të bëj vetëm një sqarim të vogël?

Kur flasim për trajnim fillestar dhe vazhdues, në ligjin e Shkollës së Magjistraturës është e përcaktuar saktësisht se çfarë nënkupton njëra dhe tjetra. Kështu që, nëse ne e përmendim që këtë detyrë do ta bëjë Shkolla e Magjistraturës, kjo do të thotë se ata e kanë të qartë se çfarë është ky trajnim. Nuk besoj se është rasti ta marrim dhe ta vendosim këtu fjalë për fjalë.

Jemi dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me mikrofon, të lutem!

Mimoza Arbi – Edhe akademia i ka planifikuar trajnimet. Kjo do të bëhet në bashkëpunim. Mënyra e organizimit do të bëhet me aktet nënligjore që do t'i nxjerrë Prokurori i Përgjithshëm në bashkëpunim me Komisionin e Policisë Gjyqësore.

Ermonela Felaj - Po, zoti Ndreu.

Pjerin Ndreu – Për sqarim, akademia krijon kushtet për të shkuar në trajnim. Ajo nuk i ka kapacitetet për të trajnuar oficerët e Policisë Gjyqësore të shërbimeve... Fiksojeni këtë! Këtë kompetencë e ka prokuroria dhe të gjitha institucionet e drejtësisë. Akademia trajnon policë, nxjerr policë rendi, krimesh, kufiri, por nuk ka kapacitete, nuk ka njerëz të certifikuar për atë punë. Mos i ngatërroni gjërat! Akademia mund të ofrojë ambientet për të marrë pjesë, meqenëse janë brenda trupës së policisë, por trajnimin duhet ta marrë përsipër prokuroria, Shkolla e Magjistraturës dhe të gjitha institucionet e drejtësisë. Janë koncepte që ndahen. Nuk mund t'ia lini akademisë këtë iniciativë. Akademia thjesht ofron akomodimin, bazën logjistike.

Ermonela Felaj – Dakord.

Nëse mundem, po propozoj një formulim për këtë pikë, që më tej t'ia propozojmë Komisionit të Ligjeve: “Shkolla e Magjistraturës dhe Akademia e Sigurisë, në bashkëpunim me Komisionin e Policisë Gjyqësore dhe Prokurorin e Përgjithshëm, kryejnë trajnimin fillestar të oficerëve të Policisë Gjyqësore”.

A jeni dakord?

Kështu i kemi bërë të dyja institucionet përgjegjëse për çdonjërin nga disiplinat që ato mund të ofrojnë si mundësi trajnimi.

Kush është dakord me këtë propozim dhe me nenin 27 të projektit?

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet neni 27.

Kalojmë te neni 28, që bën fjalë për trajnimin vazhdues të oficerëve të Policisë Gjyqësore.

Edhe këtu bëhet i njëjti sugjerim, që të shtojmë Shkollën e Magjistraturës. Mendoj se kjo i qëndron logjikës që sapo diskutuam.

Duke shtuar në përmbajtjen e nenit 28 detyrimin edhe të Shkollës së Magjistraturës për të vijuar me trajnim vazhdues të oficerëve të Policisë Gjyqësore, besoj se e sigurojmë nevojën për të pasur njerëz sa më cilësorë për kryerjen e hetimit paraprak të çështjes.

Kush është dakord me këtë sugjerim për nenin 28?

Faleminderit!

Miratohet neni 28.

Kalojmë te neni 29, i cili ka të bëjë me vlerësimin e rezolutave.

Oficerët e Policisë Gjyqësore, në mënyrë periodike, i nënshtrohen vlerësimit të punës së tyre. Neni është i ndërtuar me 7 pika. Vlerësimet janë të njohura: i paaftë, mjaftueshëm, mirë dhe shumë mirë.

Ka ndonjë ndërhyrje për nenin 29? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 29? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Faleminderit!

Miratohet neni 29.

Kalojmë te kreu VII, i cili bën fjalë për trajtimin financiar të Policisë Gjyqësore.

Do t'i ftoj kolegët, që, sikurse janë bërë kërkesat në seancat paraprake, të shikojnë të gjitha përgjigjet e ardhura nga Ministria e Financave, Prokuroria e Përgjithshme dhe Ministria e Brendshme, për trajtimin financiar të oficerëve të Policisë Gjyqësore, të prokurorëve, për të gjitha shkallët, si dhe të oficerëve të shërbimeve të Policisë Gjyqësore.

Gjatë miratimit në parim ne ruajtëm qëndrimin që të vazhdojë i njëjti raport i pagesës së oficerëve të Policisë Gjyqësore dhe prokurorëve. Pra, në qoftë se ligji aktual parashikon që paga e oficerëve të seksionit të Policisë Gjyqësore të jetë 70%, ky raport të vijojë edhe me pagën e prokurorëve, e rritur tashmë për shkak të reformës në drejtësi.

Tabelën përkatëse me të dhënat se sa përfitojnë e keni të gjithë përpara.

Dua t'ju kujtoj që paga e punonjësve të Policisë së Shtetit nuk është thjesht vetëm ajo që shënohet në tabelë, sepse për këta punonjës, edhe për shkak se ligji është i ri, ka trajtime financiare të veçanta.

Te ligji për Policinë e Shtetit do t'ju ftoj të shikoni veçanërisht nenin 66, leja pa të drejtë page; nenin 67, trajtimi financiar gjatë qëndrimit në punë; nenin 68, sigurim shëndetësor i veçantë; nenin 69, për përfitimin e kredisë me interes të butë; nenin 70, për kompensim dhe strehim; nenin 71, për sigurimin e jetës; nenin 72, për mbrojtjen e veçantë; nenin 73, për trajtimin financiar mbasi ndërpritet marrëdhënia e punës nga punonjësi i Policisë së Shtetit; nenin 74, për vjetërsinë dhe trajtimin financiar mbasi ndërpritet marrëdhëniet e punës, si dhe nenin 75, për trajtimin e familjarëve të punonjësve të Policëve të Shtetit, që humbin jetën për shkak të detyrës.

Pra, janë një set nenesh, që trajtojnë jo vetëm punonjësit e Policisë së Shtetit, por edhe familjarët e tyre, të drejtat dhe privilegjet që oficerët e Policisë Gjyqësore nuk i kanë pasur dhe nuk i kanë. Po t'i krahasojmë, ndoshta duhet t'i vendosim në një situatë të barabartë. Nuk mundet që oficerët e Policisë Gjyqësore të seksioneve të jenë më poshtë se ata të shërbimeve në trajtimin financiar. Pra, dua të them se të gjitha janë argumente, të cilat na ndihmojnë për të kuptuar që ne duhet, edhe për këto arsye, edhe për ato që i kemi thënë më parë dhe ndoshta nuk

është rasti t'i përsërisim, të ruajmë të njëjtin trajtim financiar, raportin 70% të pagës së prokurorit.

Nuk e di nëse ka ndonjë ndërhyrje nga kolegët e tjerë për këtë pikë, por u mundova ta përmbledh gjithë përmbajtjen e materialeve që kemi për këtë diskutim.

Po, zoti Luli.

Kujtim Luli – Jam dakord me argumentet që ju dhatë për ruajtjen e këtij raporti mes pagave aktuale që oficerët e Policisë Gjyqësore të seksioneve kanë me prokurorët. Siç e kam bërë me dije edhe para komisionit, ky raport është ruajtur edhe pas hyrjes në fuqi të ligjit për statusin e gjyqtarit dhe të prokurorit për pagën e prokurorëve.

Unë jam dakord me atë që argumentuat ju, pasi është një e drejtë e fituar, plus referencat që ne kemi sjellë për vendimet e Gjykatës Kushtetuese për garantimin e një të drejte të fituar me vendimet përkatëse nr. 1/2003 dhe nr. 9/2007 të Gjykatës Kushtetuese, e cila i ka shfuqizuar dispozitat e dy ligjeve për cenimin e të drejtës së fituar.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Luli!

Gjithashtu, dua t'ju tërheq vëmendjen kolegëve, meqenëse pati disa pyetje gjatë diskutimeve në parim, se si do të ruhet pagesa për oficerët e Policisë Gjyqësore që vijnë nga Policia e Shtetit. Normalisht, ata do të kenë një shtesë page, sepse angazhohen në veprimtari hetimore, që shkon deri në 10% të pagës bazë për gradën përkatëse. Njëkohësisht u diskutua edhe se si do të jetë paga e oficerëve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit, pasi ata do të marrin pjesë në hetime që kanë lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe, natyrisht, kur flasim për korrupsionin, kemi parasysh se në atë rast do të jenë subjekt të gjithë zyrtarët dhe ish-zyrtarët e lartë të shtetit. Paga e tyre do të jetë 20% më e lartë se ajo e oficerit të Policisë Gjyqësore të seksioneve. Besoj se neni 30 i projektligjit, kështu si është ndërtuar, në mënyrë hierarkike, reflekton edhe peshën e rëndësisë së punës që do të kryejë secili nga oficerët e Policisë Gjyqësore, duke filluar nga seksionet, nga shërbimet e Policisë Gjyqësore deri te Byroja Kombëtare e Hetimit. Pra, këto janë diskutimet që kemi për këtë nen.

Ka ndonjë opinion nga kolegët?

Urdhëroni, zoti Ndreu!

Pjerin Ndreu – Unë e mbështes propozimin, duke pasur parasysh edhe peshën që mbajnë oficerët e seksioneve në rastin konkret, por edhe të shërbimit. Pësia e punës që mbajnë ata është më e madhe. Normalisht që gjithçka e drejton prokurori dhe këtu nuk ka diskutim, por Policia Gjyqësore duhet të trajtohet edhe nga ana financiare, sepse pretendojmë për një strukturë drejtësie të konsoliduar dhe Policia Gjyqësore është pjesë e këtij zinxhiri dhe ne nuk

mund të bëjmë hapa pas, pasi nuk ka kuptim. Mendoj se ruajtja në 70% është domosdoshmëri, në të kundërt do të bënim një lëvizje që do të kishte kosto.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Ndreu!

Zoti Maliqi?

Lefter Maliqi – Nuk kam asgjë.

Ermonela Felaj – Zonja Dhima?

Antoneta Dhima – Në vijim të diskutimit që ne kemi bërë edhe herën e parë, mendoj se 705-shi është një e drejtë e fituar dhe duhet ta përfitojnë.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Propozimi për nenin 30 të projektit është që në pikën 1 shifra 50% e pagës bruto fillestare të prokurorit që ushtron funksionet pranë tyre, të bëhet 70%. Pra, të ruhet raporti aktual.

Kush është dakord me këtë propozim dhe me përmbajtjen e nenit 30? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni me propozimin përkatës.

Ju lutem, ne jemi Komisioni i Sigurisë Kombëtare për dhënie mendimi. Nuk gjykoj se është objekt i punës sonë të ndërhyjmë te financa.

Kalojmë te neni 31, përfitime të tjera të oficerit të Policisë Gjyqësore, që bëhet fjalë për lejen vjetore. Leja është po ajo që njihet deri sot, 30 ditë gjatë muajit gusht dhe njëkohësisht parashikohet edhe e drejta e oficerit të Policisë Gjyqësore për t'u pajisur me armë zjarri, sipas legjisllacionit për armët e zjarrit, kuptohet.

Kush është dakord me nenin 31?

Urdhëroni, zoti Maliqi!

Lefter Maliqi – Meqenëse Policia Gjyqësore është pjesë e administratës së shtetit, do të ndalesha pak te leja vjetore, e cila, si rregull, kryhet në muajin gusht. Mendoj dhe sugjeroj që leja vjetore të bëhet në bazë të kërkesave që mund të kenë oficerët e Policisë Gjyqësore dhe grafikun e vendos titullari.

(Diskutime pa mikrofon.)

Gjykata dhe Prokuroria e kanë në gusht.

Zoti Luli ka një ndërhyrje.

Urdhëroni!

Kujtim Luli – Duhet të kuptojmë si funksionon sistemi i prokurorisë. Prokuroritë e shkallës së parë janë të gjitha me shërbim gatishmërie edhe gjatë muajit gusht dhe oficerët e Policisë Gjyqësore gjatë muajit gusht janë të gatshëm pranë prokurorëve të caktuar, pra, do të

jenë në punë. Në projektligj është parashikuar se ata që nuk e bëjnë lejen në gusht, do të marrin 5 ditë leje shtesë, por sistemi i drejtësisë dhe i prokurorisë, në bazë të ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ka planifikuar që të marrin lejen e zakonshme në gusht, ndaj edhe është parashikuar kështu.

Ermonela Felaj – Neni 31 është i qartë. Kush është dakord me këtë nen?

Miratohet.

Kalojmë te neni 32 për përgjegjësinë disiplinore të oficerëve të Policisë Gjyqësore. Në nenin 32 parashikohen rregullat e përgjithshme që lidhen me përgjegjësinë disiplinore, kur lind kjo përgjegjësi dhe çfarë merret parasysh në caktimin e masave të ndryshme disiplinore ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore. Sigurisht që vlejné kriteret e përgjithshme: rëndësia e faktit që i ngarkohet oficerit të Policisë Gjyqësore, forma e fajit, nëse është kryer me dashje ose me pakujdesi, përsëritja e së njëjtës gjë apo përsëritja e shkeljeve të ndryshme dhe rrethana lehtësuese dhe rënduese. Besoj se janë gjëra të përgjithshme dhe të njohura.

Nuk ka sugjerime nga kolegët për ndryshime në nenin 32.

Ka ndonjë reflektim nga të ftuarit? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 32?

Miratohet neni 32.

Faleminderit!

Kalojmë te neni 33, “Për shkeljet disiplinore”. Në këtë rast operohet në ndarjen e shkeljeve: të rënda, të lehta dhe shumë të rënda.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ka ndonjë gjë nga kolegët për nenin 33? Nuk ka.

Kush është dakord me përmbajtjen e nenit 33 të projektit? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 34, “Për llojet e masave disiplinore”, të cilat fillojnë nga masa më e lehtë disiplinore, që është vërejtja me shkrim, dhe përfundojmë te masa më drastike disiplinore, largimi nga detyra.

Përgjithësisht janë procedura që përdoren gjithandej.

Kush është dakord me nenin 34? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 35, “Subjektet që kanë të drejtën për të kërkuar fillimin e procedimit disiplinor. Ligji parashikon të jetë Prokurori i Përgjithshëm, drejtuesi i prokurorisë, prokurori i çështjes, në të cilën rezulton të jetë kryer shkelja disiplinore, titullari i institucionit shtetëror,

që ligji i njeh funksionet e Policisë Gjyqësore, si: drejtori i Tatimeve, drejtori i Doganës, drejtori i Policisë Pyjore, secili nga ata që ne kemi thënë se ka atributet e Policisë Gjyqësore. Duket që është normale të kemi këtë rreth të subjekteve që kanë të drejtën e inicimit të procedurës disiplinore.

Kush është dakord për nenin 35? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me nenin 36, “Për procedurën disiplinore”. Pjesa e disiplinës ndonjëherë është përsëritje, sepse janë standarde që përdoren në të gjitha ligjet e ngjashme. Kush është dakord me nenin 36 të projektit? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vijojmë me neni 37 të projektit, që ka të bëjë me shqyrtimin, me fazën tjetër. Ka vërejtje nga kolegët dhe të ftuarit? Nuk ka. Kush është dakord me nenin 37?

Miratohet.

Kalojmë në nenin 38, që në raport me projektin fillestar, pika e dytë është riformuluar dhe sugjerimi ka qenë nga OSBE-ja. Bëhet fjalë që vendimi, të cilin e jep Komisioni i Policisë Gjyqësore, për sa i takon masave disiplinore, nuk jepet verbalisht, por i shkruar dhe i arsyetuar. Kuptohet, sepse, duke qenë një akt administrativ, ata që inpktohen nga ky akt, kanë të drejtë që në çdo rast të ankimohen në organin më të lartë administrativ, që në këtë rast është vetë komisioni, nuk ka shkallë tjetër, ose në gjykatë.

Kush është dakord me nenin 38? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 38.

Kalojmë në nenin 39, që ka të bëjë me ankimin, që sapo folëm.

Kush është dakord me nenin 39? Kundër? Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Do të hyjmë në dispozitat kalimtare të ligjit.

Për nenin 40: “Oficerët e Policisë Gjyqësore në prokuroritë e juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe oficerët e Policisë Gjyqësore të shërbimeve të tjera vazhdojnë t’i kryejnë funksionet e tyre aty ku janë edhe pasi ky ligj të ketë hyrë në fuqi”. Për sa u takon oficerëve të Policisë Gjyqësore, që janë te Krimet e Rënda, do të ngelen në detyrë deri kur të krijohet Byroja Kombëtare e Hetimit. Kemi juridiksionin e përgjithshëm dhe apelet i kemi shtruar aty ku flitet më specifikisht.

Kush është dakord? Kundër? Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 41, me detyrimin për nxjerrjen e akteve nënligjore që parashikon ky ligj. Ju lutem, shikoni nëse ju duken të arsyeshme afatet!

(Diskutime pa mikrofon.)

Unë mendoj që për pikën 2 dhe 3 të nenit 41, ku Komisioni i Policisë Gjyqësore detyrohet të nxjerrë rregulloren dhe akte nënligjore, afatet 3 dhe 6 muaj janë shumë të gjatë, sidomos afati 6-mujor. Praktikisht, për të vetmen punë që duhet të bëjë Komisioni i Policisë Gjyqësore, duhen 6 muaj për të vendosur. Mund të kem një mendim nga ju, zotërinj? Parimisht, si relatore e projektit, jam e mendimit t'i zvogëlojmë këto afate, sepse vetë ligji ka marrë një kohë shumë të gjatë për të ardhur deri këtu. Megjithatë, do ta respektoj opinionin tuaj.

Alfred Progonati – E lëmë si e mendoni ju, por duhet të keni parasysh se përpilimi i akteve nënligjore dhe rregullorja kërkojnë shumë punë. Aty nuk ka të prerë për 3, 4 apo 6 muaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Persone – Edhe grupi i punës, që përcaktoi këto afate, e mendoi se mund të ishin të gjata, por menduan të jenë deputetët për ta parë gjatë diskutimit. 3-4 muaj mund të jetë e vazhdueshme.

Ermonela Felaj – Pika 2 është 3 muaj për rregulloren. Pika 3 është 6 muaj për mënyrën se si do të bëhet vlerësimi i oficerit të Policisë Gjyqësore. Mund të lëmë 3 muaj për njërën dhe 3 muaj për tjetrën, për të qenë më të arsyeshëm? 6 muaj më duket realisht shumë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Oficerët e Policisë Gjyqësore vlerësohen edhe sot, nuk e keni të panjohur instrumentin si vlerësohen.

Alfred Progonati – Nuk ka një sistem, siç e kanë gjyqtarët dhe prokurorët për vlerësimin, ndaj them se kërkon shumë kohë.

E para, duhet të bëjmë një sistem pikëzimi për oficerët. Pra, është një sistem i ri, që kërkon punë, ndaj më mirë të jetë afati 6 muaj, pasi nuk prish ndonjë punë. Mua edhe 6 muaj më duket pak, por...

Ermonela Felaj –Ka ndonjë mendim nga kolegët?

Person – Në praktikën tonë, nëse lëmë 3 muaj, nuk i bëjnë as për 6, po lamë 6 muaj nuk i bëjnë as për 12. I lëmë për 3 dhe t'i bëni për 6 muaj. Kështu shkon kjo punë.

Ermonela Felaj – Atëherë, le t'i unifikojmë afatet, kolegë. T'i bëjmë 3 muaj për secilën gjë.

Kush është dakord me nenin 41, që afati për nxjerrjen e akteve të ndryshme nënligjore të jetë 3 muaj në çdo rast?

Miratohet me këtë propozim neni 41.

Kalojmë te neni 42, që ka të bëjë me shfuqizimin e ligjit aktual të Policisë Gjyqësore. Më duket normale parashikimi që keni bërë, që aktet nënligjore të vijojnë të veprojnë deri në momentin që do të nxirren aktet e reja.

Kush është dakord me nenin 42?

Miratohet.

Neni 43, “Hyrja në fuqi”.

Kush është dakord me hyrjen në fuqi të ligjit 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është dakord në tërësi me të gjitha diskutimet e mbajtura në parim dhe nen për nen dhe të gjitha reflektimet tona për këtë projektligj?

Miratohet projektligji për Policinë Gjyqësore në Komisionin e Sigurisë Kombëtare.

Faleminderit kolegëve të prokurorisë për të gjithë angazhimin e tyre!

Faleminderit dhe punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA